



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 512/prot.

Tiranë, më 25.10.2021

Lënda: Kthim Përgjigje

~~EURONEWS ALBANIA~~

Rr. "Rezervat e Shtetit", Nr.76, Lundër 1

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës suaj administruar në Institutin Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKRTK), pas shqyrtimit, verifikimeve të kryera në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)", si dhe arkiv protokollin e IKRTK-së, në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" dhe Nenit 32 të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", lidhur me informacionin e kërkuar mbi pyetjet e parashtuara Ju informojmë si vijon:

Pyetje 1: Sa është numri total i objekteve kulturore të humbura në 5 vitet e fundit?

Sqarime IKRTK: Në Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)" rezulton vetëm një objekt i humbur në 5 vitet e fundit.

Pyetje 2 : Cilat janë objektet që rezultojnë të humbura në 5 vitet e fundit?

Sqarime IKRTK: Objekti që rezulton i humbur i përket fushës së etnografisë dhe kategorisë "Veshje" me titull "**Jelek**" me KOD RKPK 62909

Pyetje 3: Ku ruheshin dhe si ruheshin?

Sqarime IKRTK: Objekti i cili rezulton i humbur ruhej nga Instituti Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pjesë e Fondit të Tekstileve

Pyetje 4: A kemi një inventar të objekteve kulturore që kemi dhe ruhen sot?

Sqarime IKRTK: Aktualisht kemi një inventar të objekteve kulturore të cilat janë në ruajtje, konkretisht Bazën e të Dhënave Shtetërore "Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)" e cila administrohet nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK).

Pyetje 5: Sa është numri i tyre?

Sqarime IKRTK: Referuar RKPK numri total i objekteve pasuri kulturore deri më datë 25.10.2021 është **479426**.

Pyetje 6: Në cilat institucione rezulton humbja e objekteve?

Sqarime IKRTK: Bashkelidhur do të gjeni “Katalogun e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të deklaruar të humbura nga Institucionet e Trashëgimisë Kulturore në vitet 1990-2016”, botuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (sot IKRTK).

Pyetje 7: Sa prej tyre janë gjurmuar dhe janë kthyer? Cilat janë ato?

Sqarime IKRTK: Nga një verifikim paraprak në Bazën e të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)” rezultojnë të kthyer objektet si vijon, pjese e fondit të Muzeut Arkeologjik Butrint:

1. Objekti me titull “Portreti i Livias (kthyer)” me nr. Inv 9 dhe KOD RKPK 196072
2. Objekti me titull “Portret vajze (kthyer)” me nr. Inv 57 dhe KOD RKPK 196071
3. Objekti me titull “Kokë e Zeusit të Asclepiusit (kthyer)” me nr. Inv 60 dhe KOD RKPK 196070
4. Objekti me titull “Shtat i Apolonit (kthyer)” me nr. Inv 4 dhe KOD RKPK 196067
5. Objekti me titull “Shtat Artemisi (kthyer)” me nr. Inv 455 dhe KOD RKPK 196066
6. Objekti me titull “Portret i Agripës (kthyer)” me nr. Inv 748 dhe KOD RKPK 195099
7. Objekti me titull “Portret vajze (kthyer)” me nr. Inv 50 dhe KOD RKPK 195098
8. Objekti me titull “Portreti i Herkulianës (kthyer)” me nr. Inv 584 dhe KOD RKPK 195098

Pyetje 8: Sa prej objekteve të humbura nuk i dihet vendi ku janë çuar?

Sqarime IKRTK: Lidhur me këtë pyetje IKRTK nuk administron asnjë informacion apo dokumentacion.

Shenim: Lidhur me pyetjet 6-7-8 referuar dhe në zbatim të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 583 datë 6.10.2021 “Për Përcaktimin e procedurave dhe mënyrave të administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura” janë duke u krijuar mundësitë për krijimin e kësaj databaze e cila do të administrojë deklaratimet, denoncimet, gjurmimin dhe rikthimin e objekteve pasuri kulturore të humbura në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Ky është një detyrim që rrjedh edhe nga zbatimi i Konventës së UNESCO – 1970 “Mbi mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të Importit dhe Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësive të Pasurive Kulturore”.

Pyetje 9: A janë konstatuar raste kur materialet janë marr nga vetë stafi që punon në institucionet përkatëse? Ku ka ndodhur?


Sqarime IKRTK: Objekti “Jelek” i sipërcituar, sipas kallëzimit penal nr. 103/8 prot. datë 05.03.2020, pjesë e fondit të IAKSA në përgjegjësinë e një specialisti të institucionit është nxjerr nga fondi arkivor me qëllim restaurimin së bashku me disa objekte të tjera dhe rezulton të mos jetë kthyer më në fond.

Pyetje 10-11: Sa objekte janë vjedhur apo kanë humbur në secilin muze dhe vepra arti në galeritë në vend? Po në sitet arkeologjike?

Sqarime IKRTK: Informacionin mbi objektet e deklaruar te humbura nga Institucionet shtetërore do ta gjeni në botimin e sipërcituar (dhe bashkëlidhur shkresës përcjellëse)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR



Sokol MUÇA



Konceptoi: *M.Qilimi*

Aprovoi: *D.Baze*